



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr.4503/3.prot.

Gramsh, më 29.10.2024

Lënda: Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak, për lëvizjen paralele në kategorinë ekzekutive, për vendet e shpallura të lira me Njoftimin nr.4503, datë 15.10.2024, pozicioni “specialist për emergjencat civile dhe strehim”.

**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**Adresa: Bulevardi “B.Curri” pranë ish-Hotel “Arbana”**

**TIRANË**

Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit dhe verifikimit paraprak të aplikimeve të dorëzuara pranë zyrës së protokoll-arkivit, për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil, për vendet e shpallura të lira me Njoftimin 4503, datë 15.10.2024, Njësia Përgjegjëse, Ju dërgon listën e kandidatëve sipas njoftimit nr.4503/2, datë 28.10.2024 “Mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizjen paralele në kategorinë ekzekutive (specialist për emergjencat civile dhe strehim)”, që do të nënshtrohen fazës së dytë të konkurimit.

Njoftimi i shoqëruar me shkresë për sa më sipër, do t’ju niset edhe me E-mail, në adresën: [vendetelirapune@akpa.gov.al](mailto:vendetelirapune@akpa.gov.al)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**KRYETARI**

**BESION AJAZI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr.4503/2.prot.

Gramsh, më 28.10.2024

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK  
PËR LËVIZJEN PARALELE  
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (specialist për emergjencat civile  
dhe strehim)**

**Lloji i diplomës “Ekonomike” niveli minimal i diplomës “Bachelor”**

Në zbatim të nenit 25 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, të Vendimit Nr. 243 datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” të Këshillit të Ministrave (ndryshuar me VKM nr.764, datë 19.012.2018),

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gramsh në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele në shërbimin civil dhe kërkesave të veçanta të shpallura në njoftimin nr.4503, datë 15.10.2024 “Shpallje për lëvizjen paralele dhe për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”, pozicioni “specialist për emergjencat civile dhe strehim” për konkurrim, njofton se:

- Nuk ka asnjë kandidat të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të procedurës;
- Këto pozicione pune janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Afatet dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve që janë të interesuar për fazën e pranimit në shërbimin civil, mbeten të njëjtat me ato të shpallura në njoftimin nr.4503, datë 15.10.2024, të publikuara në Portalin “AKPA”, faqa zyrtare e bashkisë [www.bashkiagramsh.gov.al](http://www.bashkiagramsh.gov.al) dhe stenda e informimit të publikut bashkia Gramsh.

KRYETARI  
BESJON AJAZI